



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-II.-16-0360-C0001

Paditësi:

Xh.B. Klinë, (i përfaqësuar nga avokati, Prishtinë).

Kundër

E paditura:

NSH "BK", e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Teuta Ibrahimimi më 13 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Padia në tërësi refuzohet si e pabazuar.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 14 tetor 2016 paditësi Xh.B. Klina, parashtoi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për kompensimin e pagave të papaguara për periudhat kohore si në vijim:

15 maj 1990 – 31 dhjetor 1990, ose 7 muaj e 15 ditë në shumën prej 2,787.05 euro;
1 janar 1991 – 31 maj 1999, ose 101 muaj në shumën prej 37,532.30 euro;
1 shkurt 2002 – 31 mars 2010, ose 98 muaj në shumën prej 23,544.20 euro.

Shuma e tërësishme të cilën paditësi e kërkon për pagat e papaguara është 63,863.55 euro.

Në padi kërkon nga Gjykata që padia dhe kërkesëpadia e tij të aprovohen në tërësi, që e paditura të detyrohet të paguajë pagat e papaguara për periudhat e lartcekura, kamatën si dhe shpenzimet e procedurës.

Paditësi si provë ka bashkëngjitur:

- Prokurën speciale të avokatit;
- Kërkesën për njohjen e detyrimit;
- Raportin e Komisionit të datës 31 dhjetor 2013 për njohjen e borxhit;
- Vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 20 nëntor 2013 për njohjen e borxhit;
- Vendimin individual të Bordit të Drejtorëve për njohjen e borxhit.

Më 20 mars 2018 AKP-ja paraqet mbrojtjen e saj kundër padisë së paditësit. AKP-ja ka ngritur argumentin e afatit të parashkrimit sipas Nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53, e vitit 1976) e sipas së cilës kërkesat në të cilat kërkohen pagat e papaguara parashkruhen pas një afati kohore prej 3 vitesh.

Në mbështetje të mbrojtjes së saj AKP-ja ka bashkëngjitur provat vijuese:

- Memorandumin e brendshëm të AKP-së të datës 8 shkurt 2012 lidhur me shqyrtimin dhe aprovimin e propozimit që NSH Boksitet të vihet nën Administrim direkt të AKP-së;
- Rregulloren e punës së njësisë së administrimit direkt të AKP-së;
- Vendimi i AKP-së nr. Ref. BD-83/3 i datës 31 tetor 2016 për shkarkimin e Bordit të NSH BK.
- Listën e punëtorëve aktiv të NSH BK.

Më 23 mars 2018 avokati i autorizuar i paditësit në Dhomën e Posaçme paraqet përgjigje në mbrojtje të AKP-së. Përmes kësaj përgjigjeje nga Gjykata kërkon që të refuzojë mbrojtjen e të paditurës dhe të miratojë padinë e paditësit si të bazuar në shumat e cekura në padi.

Arsyetimi Ligjor

Padia në fjalë lidhur me kompensimin e te hyrave personale të papaguara është e pabazuar.

Afati kohor për të cilën paditësi kishte kërkuar pagat e papaguara ka skaduar më 31 maj 2002; Sipas Nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, një kërkesë e tillë e arrin afatin e parashkrimit të saj brenda 3 vite. Neni 87 i Ligjit të punës nr. 03/L-212 e parasheh afatin e njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave më para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Kërkesa për pagat e papaguara është parashtruar më: 14 tetor 2016, si padi gjyqësore dhe këto shuma nuk ishin kërkuar në gjykatë asnjëherë më parë.

Skadimi përfundimtar i afatit të parashkrimit lidhur me të gjitha shumat e kërkuara, i bie të jetë 31 mars 2013.

Prandaj, Gjykata ka ardhur në përfundim se padia në fjalë në tërësi refuzohet si e pabazuar pasi që ajo është parashkruar. Afati i parashkrimit nuk ishte ndërprerë dhe për këtë paditësi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi.

Vendimi i Bordit të Drejtorëve të NSH. “BK” lëshuar më 20 nëntor 2013, që njëh kreditë e paditësit nuk ka efekt të ndërpresë periudhën e parashkrimit sepse më 20 janar 2012 NSH.-ja është vendosur nën administrim direkt të AKP-së.

Bordi i AKP-së nëpërmjet vendimit Nr. Ref. BD-83/3 ka shkarkuar Bordin e Drejtorëve të NSH-së “BK” për keq menaxhim. Si pasojë, vendimi i të shkarkuarit Bordit të Drejtorëve, që njëh borxhin nuk ka efekt në ndërprerjen e vazhdimit të periudhës së parashkrimit.

Rrethanat e mësipërme ishin ngritur nga e Paditura – AKP në përgjigjen e saj.

Duke pasur parasysh, afatin e parashkrimit, Gjykata ishte e obliguar që në tërësi të refuzojë padinë ashtu siç u tha në dispozitiv.

Për sa i përket taksave gjyqësore, Gjykata ka vendosur meqë taksa fillestare tashmë veçse është paguar, palët nuk ngarkohen me shpenzime të tjera.

Ngase u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____